



# AUTIZMI NË QARKUN E ELBASANIT

Saimir Bakalli<sup>1</sup>, Eralda Krasniqi<sup>2</sup>

<sup>1</sup>University of Tirana; Faculty of Social Science

<sup>2</sup>Joscelyn Foundation Albania

Adresë kontakti: [saimirbakalli@gmail.com](mailto:saimirbakalli@gmail.com)

## Përmbledhje

Studimi është kryer në qarkun e Elbasanit dhe përshkruan sëmundjen e autizmit i cili kohët e fundit po merr përmasa gjithnjë e më të gjëra. Rastet e shqyrtuara në këtë studim janë pjesë e punës së vazhdueshme diagnostikuese dhe trajtuese e autizmit. Risia që sjell ky studim janë shifrat e larta për qarkun e Elbasanit dhe një lobim mbi parandalimin e autizmit.

Metodologjia e këtij studimi përfshin evidentimin e të gjitha rasteve të diagnostifikuara në qarkun e Elbasanit, kjo e referuar sipas kartelave. Studimi është ndërthurje e metodave cilësore dhe atyre sasiore.

Hipotezat e këtij studimi janë: Mungesa e informimit mbi parandalimin e autizmit sjell risk tek nënat e reja. Prevalenca më e lartë është tek meshkujt. Përsa i përket objektivave, ato janë: Të masë shkallën e ndërgjegjësimit të prindërve mbi punën terapeutike të fëmijëve. Rastet e diagnostifikuara të ndjekin trajtimin. Qëllimet i këtij studimi janë që të evidentojë të gjitha rastet për qarkun e Elbasanit. Gjithashtu të informojë mbi parandalimin e autizmit dhe elementëve të tij.

Pjesa më e madhe është nga zonat urbane dhe kjo rezulton në 63% ndërsa 37% janë nga zonat rurale. Raporti meshkuj femra tregon qartë diferencën që ekziston në këtë sëmundje e cila prek më shumë meshkujt se sa vajzat. Kështu 67% janë meshkuj dhe 33% janë femra. Grupmoshat e tyre janë klasifikuar me një shkallë pesë hapshe duke nisur nga mosha 0 – 5 vjeç ku numri i të diagnostifikuarve është në 35% të tyre, ndërsa në moshën 5 – 10 vjeç rezulton edhe në shifrat më të larta në 58% të tyre dhe grupmosha e fundit është ajo 10 – 15 vjeç ku vetëm 7% nga të diagnostifikuarit rezultojnë në këtë grupmoshë.

**Fjalët çelës:** *Diagnostikim, parandalim, trajtim, sëmundje, mbështetje.*

## ***THE THEME: AUTISM IN THE DISTRICT OF ELBASAN***

### **Abstract**

The study was conducted in the District of Elbasan and describes the disease of autism which lately is increasing in a wider scale. Cases reviewed in this study are part of an ongoing work of diagnosis and treatment for autism. The innovations arising from this study are the high statistics of the district of Elbasan and lobbying on the prevention of autism.

The methodology of this study involves the identification of all cases diagnosed in the district of

Elbasan, referred according to the cards on file. The study is the combination of qualitative and quantitative methods.

Hypotheses of this study are: The lack of information on how to prevent autism brings risk to new mothers. The highest prevalence is in males. With regard to objectives those are: To measure the level of parent's awareness on children's therapeutic work. Diagnosed cases have to follow treatment. The purposes of this study are to identify all cases in the district of Elbasan, as well as to inform for the prevention of autism and its elements.

The results are the 63% are mostly from urban areas and 37% are from rural areas. Male female ratio clearly shows the difference that exists in this disease that affects more men than females. Thus 67% are males and 33% females. Their group ages are classified on a scale of five steps ranging from 0 - 5 years where there are 35% diagnosed, while at the age of 5 - 10 years results in higher rates of 58%, the last group age is 10 - 15 years where only 7% are diagnosed.

**Keywords:** *Diagnosis, prevention, treatment, disease, support.*

## Hyrje

Studimi është kryer në qarkun e Elbasanit dhe përshkruan sëmundjen e autizmit i cili kohët e fundit po merr përmasa gjithnjë e më të gjëra. Rastet e shqyrtuara në këtë studim janë pjesë e punës së vazhdueshme diagnostikuese dhe trajtuese e autizmit. Risia që sjell ky studim janë shifrat e larta për qarkun e Elbasanit dhe një lobim mbi parandalimin e autizmit.

Përsa i përket llojeve më të zakonshme të autizmit ato janë:

Asperger. Ai karakterizohet nga dëmtime në ndërveprimet sociale dhe prania e interesave dhe aktiviteteve të kufizuara, mirëpo pa vonesë të konsiderueshme të përgjithshme klinike në zhvillimin e gjuhës dhe me zhvillim të inteligjencës mesatare apo mbi mesataren<sup>1</sup>.

PDD apo AUTIZMI ATIPIK. Është një lloj diagnoze e PDD, që mund të bëhet kur fëmija nuk i plotëson kriteret për një diagnozë të caktuar, por ekziston një dëmtim i rëndë dhe i përhapur në sjellje të caktuara<sup>2</sup>.

Rett. Është një çrregullim progresiv, i cili, deri më tani, ka ndodhur vetëm tek vajzat. Karakterizohet me periudha të zhvillimit normal dhe pastaj humbjen e aftësive të fituara më parë, posaçërisht humbjen e përdorimit të duarve të zëvendësuar me lëvizje të përsëritura të duarve duke filluar në moshën 1-4 vjeç.<sup>3</sup>

Childhood Disintegrative Disorder - Çrregullim fëmijëror jointegrues. Ky çrregullim karakterizohet me zhvillim normal për të paktën 2 vjetët e para, dhe më pas me humbjen e këtyre aftësive të fituara më parë d.m.th. gjatë zhvillimit normal<sup>4</sup>. (Shoqata Amerikane e Psikiatrisë 1994)

## Rishikimi i literaturës

Përsa i përket parandalimit, ai fillon me ushqimin dhe gjendjen e përgjithshme shëndetësore tek gratë para se të bëhet me barrë. Problemi i vërtetë i Autizmit mund të fillojë gjatë shtatzënisë, edhe pse ajo nuk mund të manifestohet deri në disa vite më pas.<sup>6</sup> Shumica e grave të reja kanë varfëruar së ushqyeri trupin e tyre për shkak të dietave të tmerrshme dhe mungesës së informacionit rreth "Të Ushqyerit të Shëndetshëm".<sup>7</sup> Krahas të ushqyerit të shëndetshëm, një komponent i rëndësishëm në parandalim është edhe furnizimi i zvogëluar i oksigjenit gjatë lindjes. Studimi, një përmbledhje e 40 studimeve të botuara që para prillit 2007, është shikuar si një mori rrethanash të cilat mund të ndikojnë zhvillimin e foshnjave në fetusin e nënës gjatë sforcimeve të punës. Shkencëtarët theksojnë se këto duket të jenë të lidhura me heqjen e oksigjenit dhe

frenim të rritjes. “Furnizimi i Zvogëluar i Oksigjenit gjatë lindjes, gjatë periudhës prenatale, gjatë fillimeve të hershme, mund të ndikojë në krijimin e Autizmit”, thotë studimi i studiuesit Hannah Gardener, ScD, një epidemiolog në Universitetin e Shkollës së Mjekësisë Miller në Miami.<sup>8</sup>

Për të testuar një person nëse ka apo jo prelevancë Autike, disa analiza janë të domosdoshme për të kontrolluar gjendjen Kimiko-Biologjike të Trupit të personit<sup>9</sup>.

Të gjitha analizat e detajuara konsistojnë në zbulimin e parametrave të gjakut: anemi, niveli i homocysteines, metale të rënda; testi për alergji nga ushqimet (Immunoglobulin G / IgG)<sup>10</sup>; flokët, testi për metalet e rënda dhe paaftësia e organizmit për t'i nxjerrë jashtë ato; jashtëqitja, sasia e mykut dhe parazitëve të tjerë në sistemin e tretjes<sup>11</sup>; urina; testi i peptiteve dhe caseinës; testi i glutenit; testi i acidit organik (OAT); testi për metale toksike në urinë; profili metabolik i urinës<sup>12</sup>. Nga këto analiza rezultatet e pritshme janë: mungesa vitaminash bazë A, B, C, E, D; mungesa të mcideve yndyrore; nivele të larta të peptideve, gluten, caseine; sasia e ulur e kolesterolit, anemi; myku nga acidi citramalik, sasi e ulët Escheria Koli dhe Esterococcus; nivele të larta të homocysteinës; arabinose (sheqer jo natyral, kimikat); sasi të larta të sulfatëve në urinë; intolerancë; alergji nga disa ushqime bazë, vezë, grurë etj.<sup>13</sup>.

Kurat që rekomandohen janë Pediatria e zhvillimit, logopedia, terapitë e autizmit (janë cituar më poshtë). Më pas kryhen vlerësimet psikologjike me instrumentet sipas grupmoshës. Kështu në grupmoshën 0-2 vjeç aplikohet instrumenti Griffiths sjellja ndaj lojës ndërsa në grupmoshën 2 – 6 vjeç aplikohen instrumentet Son-R dhe Kauffman ABC. Instrumente të tjera që aplikohen janë PEP-R; PEP3 dhe ABLLS-R<sup>14</sup>.

Disa nga metodat më efikase në trajtimin e autizmit, të cilat aplikohen nga terapistët janë: ABA-analizë e sjelljeve të aplikuara; terapi për përmirësimin e të folurit/shprehurit<sup>15</sup>; PECS-Sistemi komunikimit me anë të këmbimit të fotove; koha për dysheme -terapi intensive në dysheme - për të përmirësuar ndërveprimet sociale!; terapi muzikore; integrim ndijor / ndjesive / ndjenjave; dietat e ndryshme; mjekim<sup>16</sup>.

## Metodologjia

Metodologjia e këtij studimi përfshin evidentimin e të gjitha rasteve të diagnostifikuara në qarkun e Elbasanit nga periudha 2007 dhe në vazhdim kjo e referuar sipas kartelave. Studimi është ndërthurje e metodave cilësore dhe atyre sasiore. Individët e diagnostikuar dhe të trajtuar që nga viti 2007 e në vazhdim janë 43 raste fëmijësh ku, krahas diagnostifikimit, ndjekin edhe terapitë. Ndërsa përsa i përket informimit mbi parandalimin është lobuar tek 300 individë kryesisht tek prindërit të cilët kanë ardhur pranë Qendrës Spitalore “Dr. Xhaferr Kongoli” në Elbasan dhe në Poliklinikën e Specialiteteve për vizita dhe krahas saj është bërë edhe informimi mbi parandalimin e autizmit. Pyetjet e drejtuara kanë qenë të hapura dhe të specifikuara qartë. A e dini se parandalohet autizmi? Më pas u është shpjeguar mënyra sesi mund të parandalohet dhe janë pyetur nëse e kanë ditur këtë informacion apo jo?

Hipotezat e këtij studimi janë: Mungesa e informimit mbi parandalimin e autizmit sjell risk tek nënat e reja. Prevalenca më e lartë është tek meshkujt. Përsa i përket objektiva ato janë: Të masë shkallën e ndërgjegjësimit të prindërve mbi punën terapeutike të fëmijëve. Rastet e diagnostifikuara të ndjekin trajtimin. Qëllimet i këtij studimi janë që të evidentojë të gjitha rastet për qarkun e Elbasanit. Gjithashtu të informojë mbi parandalimin e autizmit dhe elementëve të tij.

## Rezultatet

Nga të dhënat e këtij studimi rezulton se pjesa më e madhe e të diagnostifikuarve me autizëm janë nga zonat urbane dhe kjo rezulton në 63% të tyre ndërsa 37% rezulton se janë nga zonat rurale. Ajo që vërehet lehtësisht nga këto të dhëna është prevalenca e lartë tek zonat urbane dhe kjo lidhet me një sërë faktorësh, siç

janë faktorët ambientalë, mungesa e oksigjenit gjatë lindjes dhe në këtë faktor ngrihet edhe një pikëpyetje e madhe mbi këto raste sesi trajtohen gjatë lindjes nga ana e stafit. Përsa i përket raportit meshkuj femra nga të dhënat rezulton se diferenca gjinore që ekziston në këtë sëmundje referuar shumë studimeve të kryera është se prek më tepër meshkujt sesa femrat. Sipas të dhënave rezulton se më shumë të prekur janë meshkujt në 67% të rasteve ndërsa 33% rezulton se janë femrat. Këto të dhëna tregojnë edhe njëherë që prevalanca më e madhe është tek meshkujt duke mbështetur kështu të gjitha studimet të cilat e pohojnë këtë tendencë. Të diagnostifikuarit me këtë sëmundje në qarkun e Elbasanit janë klasifikuar me një grupmoshë më një shkallë pesë hapshe duke nisur nga mosha 0 – 5 vjeç ku në këtë grupmoshë do të theksojmë faktin se një fëmijë me autizëm nis ta shfaqë atë pas moshës dy vjeç. Rastet e diagnostikuara në këtë studim për këtë grupmoshë tregojnë se 35% e tyre bëjnë pjesë deri në moshën pesë vjeç por këto raste janë nga mosha tre vjeç deri në pesë vjeç. Është pikërisht kjo moshë e cila tregon se kemi të bëjmë me autizmin dhe sa më herët ta besojnë prindërit, aq më pozitive bëhet për ta ndihmuar fëmijën. Grupmosha tjetër është mosha 5 – 10 vjeç e cila rezulton edhe me shifrat më të larta në fakt. Kështu 58% e të diagnostifikuarve bëjnë pjesë në këtë grupmoshë. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe pranimi i fëmijës mbetet një nga çështjet më delikate. Kjo shifër e lartë tregon qartë sesa vonë prindi e ka dërguar për diagnostifikim fëmijën e më pas për trajtim. Grupmosha e fundit është ajo e moshës 10 – 15 vjeç ku nga të dhënat rezulton se vetëm 7% e të diagnostifikuarve bëjnë pjesë në këtë grupmoshë. Duhet theksuar fakti se edhe kjo shifër mbetet e lartë dhe tregon se cila është kultura që mbizotëron në të tilla raste.

Përsa i përket trajtimit të gjithë individët e diagnostifikuar me autizëm ndjekin terapitë e zhvillimit dhe kryesisht terapinë ABA. Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe 90% e të diagnostifikuarve ndjekin terapinë pranë qendrës së autizmit në Elbasan. Ndërsa 10% e tyre ndjekin shkollën speciale në Elbasan.

Çështja më esenciale mbetet ajo e parandalimit të autizmit. Nga të dhënat rezulton se gjatë një periudhe dy vjeçare që është lobuar për parandalimin e autizmit kryesisht tek prindërit vërehet një mungesë e madhe informacioni. Pyetjet e drejtuara të gjithë prindërve kanë qenë të tipit: A e dini se parandalohet autizmi? Nga përgjigjet e dhëna rezultoi se 97% janë shprehur se nuk parandalohet dhe nuk kanë informacion më shumë mbi të. Ndërsa vetëm 3% kanë pohuar se mund të parandalohet por nuk kanë ndonjë informacion më tej. Nga pohimet e dhëna rezulton se më tepër është me të dëgjuar sesa nga informacione të sakta. Të gjitha rasteve u është shpjeguar sesi mund të parandalohet autizmi dhe më pas janë pyetur nëse e kanë ditur këtë informacion apo jo. Të gjitha rastet kanë pohuar që nuk e kanë ditur dhe janë shprehur se ky informacion është i vlefshëm për to por edhe për rrethin e tyre familjarë. Ajo që vërehet lehtësisht është se puna më e madhe qëndron në informimin mbi parandalimin. Kështu një këshillë sot vlen shumë nesër.

## Diskutim

Autizmi ka një spektër të gjerë diagnostifikimi për shkak se çrregullimi mendor (behavior), shtrihet nga rastet e lehta klinike, deri tek ato më ekstreme behavior. Autizmi në përgjithësi shfaqet në mënyrë tipike individuale dhe si e tillë diagnostifikohet si e veçantë në çdo individ.

Gjithsesi në rastet e autizmit savant, ndonëse tek fëmijët konstatohet mangësi të mëdha në mënyrën e sjelljes dhe veprimit e përditshme rutinë, shenjat e para të kësaj sëmundje mund të vihen re nga mosha 2 vjeç. Interesi i tyre shfaqet në përshkrimin e detajeve në fushën e muzikës, artit vizual, matematikës dhe aftësisë mekanike (spaciale). Bazuar në studimet dedikuar autizmit (Frith, 2009; Selfe, 1977; Sack, 1995; Synder, 2009), fëmija autik, në moshën 5 vjeç, megjithëse shfaqte mangësi dhe paaftësi në të folur, e përgjithshme në marrëdhëniet komunikuese me fëmijët e tjerë dhe të rritur, ngathtësi dhe pa-orientim në lëvizjet e trupit, ai kishte një talent vizual të vizatuarit që ja tejkalon në kualitet moshës së tij. Fëmija autik, në këtë rast ishte në gjendje të vizatonte nga memoria detaje 3 dimensionale, me refleksion të kontrastit, dhe mocion, që zakonisht tek fëmijët normalë zhvillohen në moshën 14 vjeç e lart. Stephen Wiltshire, është ndoshta, një nga artistët anglezë më famozë, që është i diagnostikuar me autizëm. Ky është një rast

interesant që sjell dritë në studimet e zhvillimit mendor e për të kuptuar më thellë autizmin si diagnozë në fushën e neuro-shkencës. Ky rast sjell një këndvështrim ndryshe për çdo prind dhe pyetja që ngrihet është nëse prindërit kanë pritshmëri tek fëmijët e tyre? A punojnë prindërit me fëmijët?

Ndërsa një komponent shumë i rëndësishëm është edhe mungesa e oksigjenit dhe traumat gjatë lindjes të cilat janë ndër faktorët që rrisin riskun për autizmin. Pyetja që ngrihet është nëse stafi mjekësor tregohet i vëmendshëm tek këto aspekte dhe a ka informacion?

## Përfundime

Edhe pse autizmi përcaktohet nga një grup i caktuar i sjelljeve, fëmijët dhe të rriturit mund të shfaqin çdo kombinim të sjelljeve në çdo shkallë të ashpërsisë. Dy fëmijë, të dy me të njëjtën diagnozë, mund të veprojnë shumë ndryshe nga njëri-tjetri dhe të kenë aftësi të ndryshme. Nuk ka standarde “të tipit” ose “tipike” të personit me autizëm.

Terminologjia e zakonshme e përdorur për të përshkruar fëmijët brenda këtij spektri janë: autistik, tendenca autistike, spektër të autizmit, funksionimin të lartë apo funksionim të ulët-të autizmit etj.

Pjesa më e madhe e të diagnostifikuarve me autizëm janë nga zonat urbane dhe kjo rezulton në 63% të tyre ndërsa 37% rezulton se janë nga zonat rurale. Sipas të dhënave rezulton se më shumë të prekur janë meshkujt në 67% të rasteve ndërsa 33% rezulton se janë femrat. Të diagnostifikuarit me këtë sëmundje në qarkun e Elbasanit janë klasifikuar me një grupmoshë më një shkallë pesë hapshe duke nisur nga mosha 0 – 5 vjeç ku në këtë grupmoshë do të theksojmë faktin se një fëmijë me autizëm nis ta shfaqë atë pas moshës dy vjeç. Rastet e diagnostikuara në këtë studim për këtë grupmoshë tregojnë se 35% e tyre bëjnë pjesë deri në moshën pesë vjeç por këto raste janë nga mosha tre vjeç deri në pesë vjeç. Është pikërisht kjo moshë e cila tregon se kemi të bëjmë me autizmin dhe sa më herët ta besojnë prindërit aq më pozitive bëhet për ta ndihmuar fëmijën. Grupmosha tjetër është mosha 5 – 10 vjeç e cila rezulton edhe me shifrat më të larta në fakt. Kështu 58% e të diagnostifikuarve bëjnë pjesë në këtë grupmoshë. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe pranimi i fëmijës mbetet një nga çështjet më delikate. Kjo shifër e lartë tregon qartë sesa vonë prindi e ka dërguar për diagnostifikim fëmijën e më pas për trajtim. Grupmosha e fundit është ajo e moshës 10 – 15 vjeç ku nga të dhënat rezulton se vetëm 7% e të diagnostifikuarve bëjnë pjesë në këtë grupmoshë.

Përsa i përket trajtimit të gjithë individët e diagnostifikuar me autizëm ndjekin terapitë e zhvillimit dhe kryesisht terapinë ABA. Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe 90% e të diagnostifikuarve ndjekin terapinë pranë qendrës së autizmit në Elbasan. Ndërsa 10% e tyre ndjekin shkollën speciale në Elbasan.

A e dini se parandalohet autizmi? Nga përgjigjet e dhëna rezultoi se 97% janë shprehur se nuk parandalohet dhe nuk kanë informacion më shumë mbi të. Ndërsa vetëm 3% kanë pohuar se mund të parandalohet, por nuk kanë ndonjë informacion më tej. Nga pohimet e dhëna rezulton se më tepër është me të dëgjuar sesa nga informacione të sakta.

## Referenca

- 1 Autism Research Institute (www.autismresearchinstitute.com)
- 2 Uta Frith (2003) Autism: Explaining the Enigma. Blackwell, London.
- 3 Geir, M., and Geier, D., MD, “America’s Developmental Disorder Nightmare”, Dental Truth, A Publication of DAMS International, pp. 20-21, Decepmber 2003.
- 4 Autism Spectrum Disorders in adults living in Households Throughout England Report from the Adult Psychiatric Morbidity Survey 2007. Brugha, T., McManus, S., Meltzer, H., Smith, J., Scott, F.J., Purdon, S., Harris, J., J. Page Bankart.
- 5 Defeat Autism Now (www.danconference.com)(2010, pp. 12).

- 6 Miller, D.J, MD, “Mercury on the Mind”, Health Freedom News, pp. 16-18, 27 December 2004.
- 7 Miller, N.Z., Are Vaccines Really Safe and Effective, 2002, pp. 123.
- 8 “Mercury in Medicine”, The congressional Record, May 21, 2003, E1011 – E1030, pp. 35-38.
- 9 O’Shea, T., The Saneity of Human Blood: Vaccination Is Not Immunization, 2004, pp. 134-156.
- 10 Marissa King and Peter Bearman: Diagnostic change and the Increased prevalence of autism. International Journal of Epidemiology, Volume 38, pp. 13-16.
- 11 Gehan A. Mostafa and Laila Y AL-Ayadhi 2011: A lack of association Between hyperserotonemia and the Increased frequency of serum anti-myelin basic protein auto-antibodies in autistic children. In the Journal of neuroinflammation 2011, pp. 88-91.
- 12 Kanner, L. (1943). “Autistic disturbances of affective contact.” *Nerv Child* 2 : 217-50. the “Reprint” (1968). *Paedopsychiatr Acta* 35 .
- 13 Elevated cortisol During play is Associated with age and social engagement in children with autism. *Molecular Autism* 2010, pp. 56-59.
- 14 James D. Herbert, Ian R. Sharp, Brandon A. Gaudio: Separating Fact from Fiction in the etiology and Treatment of Autism. A Scientific Review of the Evidence. Commission for Scientific Medicine and Mental Health. The Scientific Review of Mental Health Practice. Spring ~ Summer 2002 Volume 1 Number 1, pp. 124-135.
- 15 Markus Jokela (2006) Genetic and environmental development of the anti-sociality. The work Honkatukia, Päivi & Stone Mountain, Janne (ed.) (2006) Youth Crime - The value of the causes and control. Youth Research Network, Youth Research Society, Advisory Council for Youth 66 publications, 33 publications pp. 137-156.